RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

SahitBeqiri - Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit:* **24.05.2022**	*Data e dorëzimit të raportit:* **31.05.2022**	*Nr. i lëndës:* **151/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **20.05.2022**, OE: **"PharmaLeader" L.L.C. –Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **151/22**, kundër **Njoftimit për dhënie te kontratës,** lidhur me aktivitetin e prokurimit:**"Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale",** me nr. të prokurimit: **206-22-509-1-1-5**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Ministria e Shëndetësisë**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës**, lloji i kontratës: **Kontratë Publike Kornizë –Furnizim** , vlera e parashikuar e kontratës: **1,377,500.00 €**

Shënim: Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerr ndonjë vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "PharmaLeader" L.L.C. –Prishtinë

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).
Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 35 i LPP-së
Neni 52.6 i RRU**OPP-së**

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Te nderur me dt. 12.05.2022 e kemi vërejtur se është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-se ku është rekomanduar për kontrate për Lot 1 OE Meditech me çmim prej 212,500.00 € dhe për Lot 2 e ka rekomanduar për kontratë OE Meditech me çmim prej 1,162,500.00€ ne lidhje me proceduren e negociuar pa publikim te njoftimit me titull "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me nr. prok: 206-22-509-1-1-5. Gjithashtu po me te njëjtën datë 12.05.2022 AK-ja ka publikuar edhe njoftimin për dhënie te kontratës te njëjtit OE.
Sa i përket nevojave për insuline, AK-ja e ka shpallur tenderin paraprak ne lidhje me aktivltetin e prokurimit me titull **"Furnizim me Insulina Analoge nga Lista esenciale me nr.prok: 206-22-2211-1-1-1,** i cili tani është i pezulluar.
Ne lidhje me këtë aktivitet te prokurimit, ne kemi parashtruar kërkese për rishqyrtim dhe me pastaj edhe ankese ne OSHP, ku me dt. 22.04.2022 kemi pranuar ekspertizën me Nr. 102/22, e ku neve na është aprovuar ankesa si e bazuar dhe është konstatuar se AK-ja ka kufizuar konkurrencën me rastin e mos përfshirjes dhe mos lejimit te ofertimit sipas UA 02/2014. Pra është konstatuar se AK-ja nuk e ka hartuar dosjen ne harmoni me konkurrencën e lire dhe e ka shkelur nenin 7 te LPP-se.
Pas pranimit te ekspertizës, ne kemi dyshuar se AK-ja mund te zhvilloj njëaktivitet tjetër te prokurimit me

procedure te negociuar, me te vetmin qellim për te favorizuar OE **Meditech** dhe këtë dyshim e kemi bazuar ne faktet e kaluara dhe ne përvojat e kaluara kur AK-ja ka tentuar të favorizoj këtë kompani për disa here me radhe, ndërsanjëjtë ka vepruar edhe tani ku dyshimet tona po vërtetohen.

Duke u nisur nga përvojat e kaluara ne lidhje me aktivitetin e prokurimit furnizimi me insuline dhe duke pa tendencën e AK-se për te favorizuar kompaninë e caktuar **Meditech** ne me dt. 27.04.2022 ju kemi drejtuar AK-se me një shkresë si ne vijim, citojmë:
Te nderuar,

Duke e marre parasysh se tenderi me numër te prokurimit 206-22-2211-1-1-1 i datës 22.03.222 për Furnizimi me Insulina Analoge është i pezulluar nga AK-MSH, i cili ka qene me procedure te përshpejtuar (shkurtuar), pas pezullimit AK zakonisht praktikon procedurën e negociuar pa publikim te njoftimitpër kontrate. Prandaj, si pale e interesuar ne kuadër te nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-se shprehim interesimin për te marr pjese ne një procedure te tille, dhe kërkojmë qe AK-MSH te na ftoj ne rast se një procedure e tillëzhvillohet nga AK- MSH për Furnizim me Insulinë Analoge, e qe është obligim ligjor.
Për sa më sipër, Zyra e Prokurimit e AK-MSH-së duke mos respektuar vendimet dhe mendimet e OSHP-se për tenderët për Furnizim me Insulina Analoge, përkatësisht tenderët me numër te prokurimit 206-22-2211-1-1-1 dhe 206-22-8397-1-1-1, me qellim për te kufizuar konkurrencën ne dobi te një operatori ekonomik, vazhdimisht mundohet te zhvilloj procedura prokuruese duke mos respektuar LPP-ne dhe Ligjin Nr. 04/L-190 për Produkte dhe PajisjeMedicinale, si dhe aktin nen-ligjor UA 02/2014 te nxjerr nga vet AK-MSH për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve pa paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.
Nëse Zyra e Prokurimit te AK-MSH përmes zhvillimit te procedurave te negociuara pa publikim te njoftimit për kontratës, ka për qellim te përjashtoj PharmLeader, si operator ekonomik i interesuar, duke përjashtuar aplikimin e UA 02/2014, përkundër se ky udhëzim është ne fuqi gjë e cila është konfirmuar nga vendimet e OSHP-se dhe raporti i ekspertit shqyrtues te OSHP te datës 21.04.2022, ku i ka dhënë te drejt kompanisë tone me ankesën lidhur me përfshirjen e UA 02/2014 ne Dosjen e Tenderit, si dhe Agjencioni kompetent AKPPM sipas Ligjit Nr. 04/L-190, e cila ka lëshuar Licence për import te produkteve pa paralele te regjistrua ne Republikën e Kosovës për sasi te pa limituara te produkteve te cilat janë pjese e kërkesës se dosjeve te tenderëve te AK-MSH, ne pajtim me nenin 4 te UA 02/2014.
Ne rast se kërkohet furnizimi me urgjence sipas paragrafit 2.1 te nenit 35 te LPP-se, dëshirojmë te ju njoftojmë se PharmLeader i ka produktet e kërkuara ne depon tone farmaceutike, te cilat janë prodhim i kompanisë se njohur amerikane EilLilly, dhe ka mundësi te furnizimit te menjëhershëm.
Ne te kundërtën, nëse përjashtohemi nga ftesa për pjesëmarrje, do te detyrohemi te ndërmarrim te gjitha mjetet juridike për te mbrojtur ligjshmërinë dhe interesat ekonomike te kompanisë te cilat ne vazhdimësi po cenohen nga Zyra e Prokurimit te AK-MSH ne kundërshtim me Rregullat dhe Ligjin e Prokurimit Publik ne Kosove, dhe Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale.
P.S. Bashkangjitur gjeni vendimin e OSHP-se nr. 240/21 te datës 25.03.2022 dhe Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. 102/22 te datës 21.04.2022. ***Mbarim citati****.*

Ne po ashtu me dt. 04.05.2022 ju kemi drejtuar AK-se edhe me një shkrese si ne vijim, citojmë:

"Te nderuar,

*Edhe pse Ju kemi shkruar edhe me pare po e përsërisim, bazuar ne kuadër te nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP kërkojmë nga Ju, Zyrtare te Prokurimit Përgjegjëspër inicimin e procedurave te prokurimit, ne rast se iniconi****Procedurëne negociuar pa publikim tenjoftimit te kontratës për Furnizim me Insulina Analoge*** *, si pale e interesuar dhe pjese e te gjitha aktiviteteve te deritanishme ne lidhje me këto produkte, dhe vendimeve te OSHP, ku kërkesat e tona janë aprovuar bazuar ne LPP dhe Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale, te*

na dërgoni ftesën-Dosjen e tenderit për furnizim me Insulina Analoge, ne te kundërtën do te detyrohemi ti ndjekim procedurat ligjore" **Mbarim citati.**

Shkresën e lartpërmendur e kemi plotësuar edhe me dt. 05.05.2022 ku i kemi informuar si ne vijim:

Citat "*Për te sqaruar emalin tone te mëposhtëm dhe kërkesën tone për pjesëmarrje ne një tender te mundeshim pa publikim te kontratës, ju informojmë se Insulinat Analoge qe kane qene pjese e kërkesave për furnizim nga ana e MSH, kompania jone i ka ne Depo Farmaceutike dhe mund te beje furnizimin e menjëhershëm, gjithashtu nekemi Licencë për Import te produkteve te kërkuara (Insulina Analoge) dhe mund te importojmë çfarëdo sasie qe mund te kërkohet nga ana juaj*" **mbarim citati**.

AK-se ne lidhje me tenderin për insulina është munduar çdo here për te favorizuar një kompani, e ajo kompani është**Meditech.**ndërsa ky fakt po vërtetohet edhe tani ku AK-ja ka iniciuar PROCEDURE EMERGJENTE E NEGOCIUAR pa publikim te njoftimit për kontrate dhe si përfundim ka ftuar vetëm OE Meditech dhe te njëjtin e ka rekomanduar për kontrate, dhe për me tepër ka publikuar me te njëjtën date 12.05.2022 si njoftim mbi vendimin e AK-se, ashtu edhe njoftimin për dhënie te kontratës.

Sa për rikujtim ne lidhje me tenderin metitull "Furnizimi me insulina analoge nga Lista esenciale për Lot 1 dhe 3 me Nr. prok.: 206-20-8397-1-1-1" ne kishimparashtruar ankese ne OSHP, e ku ishte lëshuar një ekspertize me nr. 240/21 e dt. 19.03.2021 dhe me pastaj vendimi nga paneli shqyrtues me Nr. 240/21 i dt. 25.03.2021, ku neve na është aprovuar ankesa dhe lënda është kthyer ne rivlerësim. Në këtë aktivitet te prokurimit ne kishim ofertuar sipas UA 02/2014 ashtu siç ishte lejuar edhe përcaktuar edhe ne dosjen e tenderit dhe kishim ofertuar me çmim rreth 400 mije euro me lire se sa OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa OSHP-ja e kishte konstatuar se ne ishim eliminuar pa te drejtë.

pas rivlerësimit AK-ja përsëri e ka rekomanduar për kontrate OE e njëjte me çmim rreth 400 mije euro me shtrenjte duke mos respektuar vendimin e panelit shqyrtues dhe duke favorizuar OE e njëjtë.
Pas rivlerësimit, ne përsëri kemi parashtruar ankesë ne OSHP dhe ankesa ishte aprovuar përsëri, por nga një ekspert tjetër me ekspertizën Nr. 397/21 te dt. 31.05.202, mirëpo me pastaj OSHP-ja kishte mbetur pa Bord dhe nuk është nxjerr një vendim përfundimtar, me ç'rast lënda ka mbetur e pezulluar

Pavarësisht këtij pezullimi, AK-ja me dt.22.03.2022 ka publikuar njoftim për kontrate ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull **"Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me nr. prok: 206-22-2211-l-1-1 te ndare ne dy Lote.**

Ne këtë aktivitet te prokurimit AK-ja ka bere ndryshim ne FDT tek kërkesat ne lidhje me kapacitetin teknik/profesional duke e larguar nga dosja e tenderit UA 02/2014 dhe duke e kufizuar mundësin e ofertimit sipas UA 02/2014. Këtëveprim e ka ndërmarr me te vetmin qellim qe te na eliminon neve nga konkurrenca dhe ta favorizon kompaninë **Meditech**, sepse e ka vërejtur nga vendimi paraprak i OSHP-se se kur lejohet te ofertohet edh sipas UA 02/2014, atëherë ne do te jemi fitues dhe ofertojmë me çmim me te lire.
Edhe ne këtë procedure te negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate ka vepruar njëjtë duke mos lejuar qe te ofertohet sipas UA 02/2014, me te vetmin qellim qe ti sigurohet kontrata një OE, e ky dihet qe është Meditech.

Pra është shume e lehte e kuptueshme tendenca e AK-se për te na diskriminuar neve si kompani serioze dhe e përgjegjshëm dhe tendenca e AK-se për te favorizuar një kompani tjetër. Për me tepër, për ne është shume i çuditeshim guximi dhe vendosmëria e AK-se për te tentuar pa kufi ta favorizoj një kompani te caktuar dhe ta kufizon konkurrencën, e me këtë veprim edhe ta rrezikoj dëmtimin e buxhetit te Shtetit.
Edhe tani ekspertiza e ekspertit te OSHP-se, me nr. 102/22 e dt. 21.04.2022 e ka konstatuar se AK-ja pa te drejt e ka larguar nga dosja e tenderit UA 02/2014 dhe e ka kufizuar konkurrencën, ndërsa e ka favorizuar një OE te caktuar.
Duke pasur parasysh këtë kronologji dhe mund te themi këtë histori te prokurimit për furnizim me Insulina dhe duke e pasur parasysh tendencat e njëpasnjëshme te AK-se për favorizim te hapur te kompanisë Meditech, ne e kemi pritur se AK-ja do ta zhvilloj një procedure te negociuar dhe ta favorizoj kompaninë e saj te preferuar, se paku ne ketë mënyrë,

sepse me procedura te rregullta nuk po e arrin ta shpall fitues ligjërisht.
AK-ja edhe ne këtë aktivitet te prokurimit, duke mos lejuar qe te ofertohet sipas UA 02/2014 dhe duke ftuar vetëm një kompani për negocim e ka kufizuar konkurrencën dhe e ka favorizuar vetëm një kompani, pavarësisht qe ne kemi paralajmëruar AK se jemi pale me interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-se dhe **se kompania jone i ka ne Depo Farmaceutike Insulinat dhe mund te beje furnizimin e menjëhershëm, gjithashtu ne kemi Licence për import te produkteve te kërkuara (Insulina Analoge) dhe mund te importojmë çfarëdo sasie qe mund te kërkohet nga ana e AK-se.** AK-ja me këtë veprim e ka shkelur nenin 7 te LPP-se duke mos i trajtuar barabartë operatoret ekonomik dhe duke e kufizuar konkurrencën dhe njëkohësisht ky veprim i saj i bie ne kundërshtim edhe me parimin e qëllimit te Ligjit për Prokurim Publik

E gjithë kronologjia qe e përshkruam me larte dhe i tere procesi i filluar ne fund te vitit 2020 e tregon me se miri tendencën e AK-se për favorizim te kompanisë Meditech dhe te diskriminimit te kompanisë tone. Po te analizohen ne tërësi këto aktivitet, madje edhe nga ndonjë laik i kësaj fushe, kuptohet tendenca e AK-se për favorizim përkatësisht diskriminim te kompanive te caktuara.

Duke pasur parasysh qe ne si kompani serioze kemi licence importi dhe kemi realizuar kontrata dhe po ashtu jemi ne realizim e sipër te disa kontratave te tjera, kërkojmë nga ju qe ta detyroni AK te anuloj këtë procedure te prokurimit dhe te rifilloj edhe një here këtë procedure dhe te hap konkurrencën, duke na ftuar edhe neve te jemi pjese e negociatave me qellim te respektimit te nenit 7 te LPP-se dhe me qellim te zbatohet edhe parimi i qëllimit te ligjit te prokurimit publik, e siç e din vet AK-ja. Qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosove.

Ne këtë procedure te prokurimit gjithçka mund te këtë tjetër përveç transparencës, e mos transparenca shpi ne favorizim te hapur te një kompanie dhe ne drejtim te monopolit.

Tendenca e AK-se shihet hapur edhe kur merret parasysh fakti se AK-ja ende pa u kryer afati ligjore për rishqyrtim te ankesës, e ka shpall këtë procedure te negociuar pa publikim. Ankesa jone është dorëzuar ne OSHP me dt. 15.04.2022, ndërsa afati për te nxjerr një vendim është diku 34 dite, e qe ne rastin e caktuar mund te shtyhet edhe me shume.

Deri te kjo procedure ka ardh pikërisht me fajin e AK-se dhe me tendencat e saj, ndërsa eshë zhvillimi i kësaj procedure duke e ftuar vetëm një operatore ekonomik e dëshmon qarte qëllimin e AK-se, se perse e ka sjell ne këtë situatë dhe ne këtë gjendje Ministrin e Shëndetësisë sa i përket furnizimit me insulina.

Pra vet ngutja e AK-se tregon me se miri qëllimin e saj. **Ne baze te informatave qe ne i kemi, insulina k ase paku edhe për një muaj ne Ministri te Shëndetësisë, prandaj ngutja e AK-se nuk ka te beje fare me mungese te insulinave por me përpjekjen e saj për te nënshkruar kontratën me OE Meditech.**

Ne me dt. 19.05.2022 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kësaj krekës për rishqyrtim, pra ne ditën e gjashte te afatit për kthim te përgjigjes. Edhe pse autoriteti kontraktues është dashur te na njoftoj për shtyrje te afatit për rishqyrtimin e kërkesë për rishqyrtim, një gjë te tille nuk e ka bere pas ditës se trete, duke shkelur nenin 108/A paragrafi 6 te LPP-se.

Aq sa ne jemi ne dijeni dhe sa e kemi përcjell ne e-prokurim, autoriteti kontraktues nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, edhe pse ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me dt. 13.05.2022, prandaj ky AK nuk e ka respektuar nenin 108/A paragrafi 6 te LPP-se, sepse aty shkruan qarte "*Dorëzimi i një kërkese për rishqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues qe automatikisht te pezulloj zbatimin e aktivitetit te prokurimit me te cilin ka te beje shkelja e pretenduar*".
Prandaj kërkojmë nga OSHP-ja qe ta analizoj edhe këtë pretendim dhe te konstatoj saktë shkeljen ligjore, sepse këto shkelje te zyrtarit përgjegjës te prokurimit janë shkelje serioze dhe duhet kërkuar nga KRPP-ja qe te ndëshkohen zyrtaret përgjegjës.
Sa i përket konstatimit te AK-se se ne dy aktivitet te kaluara nuk kane pranuar ndonjë vendim nga OSHP ne mungese te Bordit dhe se kane mbetur te pezulluara këto dy aktivitetet te prokurimit, ju sqarojmë se ne aktivitetin e dyte e qe ne kemi parashtruar ankese ne OSHP me dt. 15.04.2022 dhe se AK-ja nuk e ka pritur te kaloj afati ligjore për nxjerrje te

vendimit nga ana e OSHP-se por ka vazhduar me procedurë te negociuar pa publikim te njoftimit duke e shpallur me dt. 29.04.2022. Pra nga ngutja qe te nënshkruaj dhe te favorizoj OE Meditech, AK-ja nuk ka pritur afatin ligjore për lëshim te vendimit nga OSHP-ja, por ka zhvilluar procedure te negociuar pa publikim te njoftimit për kontratë.

Sa i përket arsyetimit te AK-se se rrezikohet shëndeti i mbi 15 mije pacienteve insulin-vartes dhe se për ketë arsye është zhvilluar kjo procedure e negociuar, ju sqarojmë se ky është vetëm një tendence për arsyetim sepse zhvillimi i kësaj procedure nuk ka te beje fare me qëllimin për te ruajtur shëndetin e pacienteve por ka te beje pikërisht me tendencën për te nënshkruar kontrate me një operator ekonomik te përkëdhelur dhe te favorizuar nga ana e Ministrisë se Shëndetësisë.

Nëse do te ishte qëllimi për te ruajtur shëndetin e pacienteve ashtu siç proklamon Ministria e Shëndetësisë atëherë do te respektohej vendimi i OSHP-se Nr. 240/21 i dt. 25.03.2021, ku na është aprovuar ankesa dhe lënda është kthyer ne rivlerësim. Pra nëse do te ishte me te vërtet qëllimi për te ruajtur shëndetin e pacienteve atëherë do te ishte zbatuar vendimi i lartpërmendur i OSHP-se dhe për me tepër edhe do te ishte kursyer buxheti i Ministrisë se Shëndetësisë rreth 400 mije euro. Ne këtë rast, nëse ne do e ishim shpallur fitues, siç na ka dhënë te drejt vendimi i lartpërmendur përfitimi do te ishte edhe ne ruajtjen e buxhetit edhe ne ruajtjen e shëndeti te pacienteve dhe natyrisht edhe do te respektohej vendimi i një organi te shkalles me te larte siç është OSHP-ja.
Ministria e Shëndetësisë ku i konvenon thirret ne mungesën e bordit te OSHP-se ndërsa kur nuk i konvenon nuk e respekton vendimet e OSHP-se siç është rasti me vendimin Nr. 240/21 i dt. 25.03.2021, pra përdorë standarde te dyfishta pa asnjë përgjegjësi ligjore.
Ky konstatim i yni shume lehet vërtetohet, nëse keni me te vërtet interesim për te zbardh te vërteten ne lidhje me tenderët për insulina
Perse e themi këtë, është fakti se ne tenderin e pare e qe është pezulluar dhe ka mbet ne OSHP ne mungese te Bordit, dosja e tenderit ka përmbajtje përveç autorizim marketingut sipas UA 01/2015 edhe kërkesën sipas UA 02/2014. Për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kane paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

Në këtë procedure te prokurimit ishte lëshuar një vendim i panelit shqyrtues ku na kishin dhënë te drejt kompanisë tone dhe na ishte aprovuar ankesa, mirëpo edhe pas rivlerësimit AK-ja e kishte shpërblyer me kontrate te njëjtin OE edhe pse ishte me çmim me te shtrenjtë rreth 400 mije euro se sa oferta jone.
Kronologjia ne lidhje me këto procedura është shpjeguar me larte, prandaj kuptohet qarte tendenca e AK-se për favorizim te kompanisë se caktuar dhe tendenca për te na eliminuar neve nga konkurrenca me çdo kusht.

Sa i përket sqarimit te AK-se se kinse janë ftuar dy operatore ekonomik te cilët kane pasur autorizim marketing, ju sqarojmë se edhe ne këtë sqarim, AK-ja nuk e ka thënë te vërtetën plotësisht për kompanitë qe kane autorizim marketing ne lidhje me insulinat e kërkuara, sepse për Lot 2 nuk ka autorizim marketing asnjë kompani tjetër përveç OE Meditech, dhe se ne e kemi sqaruar edhe ne ankesën e kaluar se:

Sa i përket Lot 2, - Insulin analoge bifazike (premix) me veprim te shpejte dhe te mesëm shiringë e para mbushur, 100 IU ml, 3ml, ne tregun botërorë janë gjithsejtë dy prodhues me ATC Code te ndryshme:

1. NovoMix 30 FlexPen nga prodhuesi Novonordisk- Danimark me ATC Cod A10AD05
2. HumanlogMix 25 KwikPen nga prodhuesi EliLilly&Company me ATC Cod A10AD04.

Pra kompania Meditech është përfaqësues e insulinës me numër rendor 1, ndërsa kompania jone PharmaLeader është përfaqësuese e insulinës me numër rendor 2

Ne nuk kemi autorizim marketing, mirëpo ne siç e kemi cekur edhe ne ankesën e kaluar e edhe ne ankesat tjera, ne kemi leje importi dhe kuptohet qe produkti jone është paralele sipas UA 02/2014, sepse niveli i 5 te ATC Code (siç shihet) është i ndryshëm, prandaj është dashur te ftohemi ne këtë aktivitet te prokurimit si pale me interes sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, sepse produkti jone nuk ka paralel te regjistruar, por qëllimi i AK-se po shihet qarte qe te mos përfshihet ne dosjen e tenderit mundësia e ofertimit sipas UA 02/2014 e me këtë rast te goditemi n edhe ti hapet rruga për te fituar kontratën njeri operatore ekonomik.

Ndërsa sa i përket Lot 1, - Insulina analoge meveprim te shpejte, shiringe e parambushur, 100 IU ml, 3ml, ju sqarojmë se ne tregun botërorejanëgjithsejtë tre prodhues me ATC Code te ndryshme:

1. NovorapidFlexPen nga prodhuesi Novonordisk – Danimark me ATC Cod A10AB05
2. APIDRA SoloStar nga prodhues Sanofi- AventisDeutschland me ATC Code A10AB06
3. HumalogKwikPen nga prodhuesi EliLilly&Company me ATC Code A10AB04

Siç shihet te tri produktet kanë ATC Code te ndryshme, ku dy te paret kane Autorizim Marketing, ndërsa e treta qe kompania jone e përfaqëson nuk ka AM, por kuptohet qe produkti jone është pa paralele sipas UA 02/2014, sepse niveli i 5 te ATC Codeështë i ndryshëm.
Sa për sqarim, kompania e cila përfaqëson produktin Nr. 2 ne renditje, nuk ka marr pjese asnjëherë neper tender ne Kosovës, dhe autoriteti kontraktues tenton te arsyetohet se kinës ka pas konkurrence te mjaftueshme. Edhe ne këtë Lot, është diskriminuar kompania jone qe kemi produktin pa paralele sipas UA 02/2014 dhe për këtë arsye është dashur te përfshihet ne dosje te tenderit mundësia e ofertimit sipas UA 02/2014. Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importimin e produkteve medicinale te cilat nuk kane paralele te regjistruara ne Republikanë e Kosovës.

Duke e ditur situatën saktë, AK-ja e ka zhvilluar këtë procedure dhe ka kufizuar konkurrencën duke lejuar si kërkesë vetëm autorizim marketingu dhe duke mos lejuar qe te ofertohet edhe sipas UA 02/2014, me te vetmin qellim qe te nënshkruaj kontrate me ne fund pas dy viteve dhe pas shume përpjekjeve me OE e favorizon Meditech.

Sa i përket arsyetimit se Ministria e Shëndetësisë duhet te zbatoj Ligjin Nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, i cili ligj mbizotëron ndaj akteve tjera nënligjore, ju sqarojmë se ky arsyetim është me te vërtet absurd i llojit te vet, sepse juridikisht çdo akt nënligjor duhet te jete edhe ne përputhje dhe harmoni me ligjet përkatëse, prandaj edhe udhëzimet administrative janë ne përputhje te plotë me Ligjin Nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale dhe natyrisht qe duhet te zbatohen edhe udhëzimet administrative ne fuqi e qe nënkuptohet qe duhet te zbatohet edhe UA 02/2014. Për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importimin e produkteve medicinale te cilat nuk kane paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.
AK-ja ne arsyetimin e tyre i referohet ne mënyrë selektive neneve përkatëse te Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale duke i cekur vetëm nenet qe iu përshtatet atyre, e po ashtu i referohen edhe neneve te UA 02/2014. Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kane paralele te regjistruar ne Republikën e Kosovës, vetëm ku i përshtat atyre, prandaj ky arsyetim dhe referim është me te vërtet tendencioz, përveç se është jo profesional dhe shpreh njëanshmëri te plote për te tentuar te mjegulloje te vërteten.

Sa i përket arsyetimit te AK-se, segjoja këta janë njoftuar nga UNOPS ne lidhje me refuzimin e ankese tone ne një aktivitet te prokurimit, ju sqarojmë se kjo është plotësisht e pavërtetë, sepse nekemi dëshmi qe AK-ja/Ministria e Shëndetësisë vete i ka sugjeruar UNOPS-in qe ta heq nga kërkesa UA 02/2014, Arsyetimi i AK-se ne ketëmënyrë shfaq saktë mungesën e argumenteve profesionale ne hartimin e dosjes se tenderit dhe zhvillimin e procedurës se negociuar, duke tentuar te përdorë edhe ndonjë dëshmi te ndonjë aktiviteti tjetër me qellim qe te krijoje bindje tek OSHP-ja kinës kane te drejte ne atë se nuk duhet te lejohet ofertomi edhe sipas UA 02/2014.

AK-ja ne arsyetimin e tyre ka thënë se kërkesa për rishqyrtim nuk e pengon ne nënshkrimin e kontratës bazuar ne opinionin e KRPP-se tek pyetjet e shpeshta, tek pyetja Nr. 77 sipas te cilit potencohet

"*Megjithatë, në rastin e Procedurave të Negociuara pa Publikimin e Njoftimit për kontratë siç përcaktohen rastet e emergjencave ekstreme me nenin 35.2.1 (iii) të LPP, AK mund të nënshkruaj kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave, sepse ky kusht përjashtohet me nenin 26, paragrafin 4, nën paragrafin 4.1 të LPP-së*".

Edhe ky referim është i pjesshëm dhe jo real, sepse AK-ja i merr për baze vetëm përshkruhet te cilat i konvenojnë qofte te dispozitave ligjore, qofte te interpretimeve te KRPP-se, e ky veprim i tyre është me te vërtet tendence edhe për te manipuluar dhe për te mjegulluar situatën reale, me te vetmin qellim për te arritur qëllimin e tyre, nënshkrimin e kontratës me OE e favorizon nga AK-ja.

AK-ja nuk e cek pjesën tjetër te interpretimit te KRPP-se ku thotë se "*Si rrjedhojë, edhe në rastin e Procedurave të negociuara pa Publikimin e Njoftimit për Kontratë, një OE mund të parashtrojë një Kërkesë për Ri-shqyrtim të vendimit të AK-së,* ***nëse të njëjtin AK ka mund të ftojë që të dorëzojë ofertë, por që nuk e kaftuar*****.**

Gjithashtu, AK-ja nuk i referohet pjesës tjetër te interpretimit te KRPP-se tek pyetja e 77, ku shkruan, citojmë: *Megjithatë, në rastin e Procedurave të Negociuara pa Publikimin e Njoftimit për kontratë siç përcaktohen rastet e emergjencave ekstreme me nenin 35.2.1 (iii) të LPP, AK mund të nënshkruaj kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave, sepse ky kusht përjashtohet me nenin 26, paragrafin 4, nën paragrafin 4.1 të LPP-së.*

Si rrjedhojë, efekti i pezullimit nuk vlen vetëm në rastet e emergjencave ekstreme siç përcaktohen me nenin 35.2.1 (iii) të LPP-së, si në vijim, citat

- *nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.*

Në raste të tjera (jo emergjente ekstreme) të Procedurave të negociuara pa publikim e Njoftimit për Kontratë AK nuk mund të nënshkruaj kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave.

Siç kuptohet nga ky interpretim i KRPP-se, rezulton se pezullimi ne ketë rast duhet te vleje pasi qe nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara, pasi që në këtë rast nuk kemi emergjence ekstreme e aspak nuk kemi urgjence te shkaktuar nga ngjarje objektivisht te verifikushme dhe qe nuk kane mundur te parashikohen, pasi qe këto procedura janë duke u zhvilluar qe dy vite, e OSHP-ja ka mbet pa Bord qe nga Prilli i vitit 2021 dhe këto ngjarje kane mundur te parashikohen se paku qe një vit dhe te mos lejohet te vihet ne vete situata te ashtuquajtur emergjente.

Për me tepër kjo situatë ka ardh pikërisht për shkak te neglizhencës se AK-së, e kjo bie ndesh me dispozitat e LPP-se neni 35.2.1 (iii) dhe sqarimet te KRPP-se, prandaj duhet te mbetet i pezulluar ky aktivitet derisa te shqyrtohet e te mos nënshkruhet kontrata sepse nënshkrimi eventual i kontratës do te bie ndesh me dispozitat e lartpërmendura te LPP-së dhe te interpretimit të KRPP-së tek pyetjet me Nr. 77.

Kjo procedure nuk mund te quhet procedure emergjente, kur shihet se afati i liferimit është përcaktor të jetë 15 ditë, ndërsa nxjerrja e urdhër blerjes është përcaktuar të jetë 5 ditë, e qe nga sqarimi i lartcekur kuptohet se furnizimi me insulina do te behet për 20 ditë, por ky fakt tregon qarte se kjo procedure nuk mund te quhet procedure emergjente, e leje me emergjence ekstreme siç e ka quajtur AK-ja ne vendimin për refuzime te kërkese për rishqyrtim, mirëpo ky është vetëm një pretekst i AK-se për favorizimin e OE Meditech.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se AK-ja nuk e ka hartuar dosjen e tenderit ne mënyrë profesionale dhe nuk e ka hartuar ne atë mënyrë qe te mundësoj konkurrence me te madhe por e ka hartuar ne atë mënyrë qe te favorizoj direkt vetëm një kompani, pasi qe ne dosje te tenderit si dëshmi e ka kërkuar **"Autorizim për Marketing nga AKPPM, me dozën e produktit te kërkuar" , mirëpo nuk e ka përcaktuar se mund te ofertohet edhe sipas UA 02/2014**. Për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinave te cilat nuk kane paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.
Prandaj doja e tenderit është dashur te hartohet ne atë mënyrë qe te lejoje mundësinë e ofertimit dhe për produktet qe nuk kane paralele te regjistruara pra sipas UA 02/2014, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja qe te detyroje AK-ne te anulojë këtë procedure te prokurimit, dhe te detyrohet te ndërhyj dosjen e tenderit me qëllim te lejimit te ofrimit edhe sipas UA 02/2014.

Nga te gjitha faktet qe u ceken mel arte kuptohet qarte tendenca e favorizimit e bere nga ana e Ministrisë se Shëndetësisë dhe e diskriminimit njëkohësisht, duke mos respektuar nenin 7 te LPP-se, ku ne paragrafin 2 te këtij neni ceket qarte "*Autoriteti kontraktuesnuk dot e ekzekutoj asnjë aspekte te aktivitetit te prokurimit ne një mënyrë qe redukton apo eliminon konkurrencën ne mes te operatoreve ekonomik ose qe diskriminon ne dëm ose në të mirë të një ose me shumë operatoreve ekonomik*".
Veprimi i AK-se ka rene ndesh edhe me paragrafet e tjerë te këtij neni siç janë paragrafi 1, 3, 4, 6.

Edhe nenin **52.6 i RRUOPP** e parasheh qe: "*Pjesëmarrësit ne procedurën e negociuar pa publikime te njoftimit për kontrate duhet te përzgjidhen ne mesin e operatoreve ekonomik te përshtatshëm si dhe duhet te ftohen për te marr pjese nga ana e autoritetit kontraktues duke mos pasur për qellim diskriminimit kundër apo ne te mire te ndonjë Operatori ekonomik*".

Edhe ne këtë nen parashihet qe duhet ftuar operatore ekonomik te përshtatshëm dhe nuk duhet pasur qellim diskriminimin, prandaj AK-ja ne këtë rast ka rënë ndesh me këtë dispozitë sepse nuk ka ftuar neve edhe pse jemi te përsheshem dhe me përvojë ne këtë lëmi, mirëpo na ka diskriminuar me mos ftese për ofertim.
Këto veprime ne nenin 1 te këtij ligji, e ku shkruan qarte: *"Qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve te tjerat e autoriteteve kontraktuese ne Kosove*".

Duke pasur parasysh te gjitha arsyet ligjore qe u përmendën me larte, kërkojmë nga OSHP-ja qe te merr:

VENDIM

APROVOHET – ankesa e OE **"Pharma Leader" L.L.C.** si e bazuar
ANULOHET – njoftimi mbi vendimin e AK-se dhe njoftimi për dhënie te kontratës te dt. 12.05.2022
ANULOHET – procedura e negociuar pa publikime te njoftimit për kontraste dhe
DETYROHET AK-ja te inicioje një procedure te re me qellim te hapjes se konkurrencës dhe te ndryshohet dosja e tenderit dhe te ftohemi ne si kompani serioze dhe pale me interes ne këtë procedure te negociuar pa publikime.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues,
Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë shtuar dhe plotesuar nga ajo e dorëzuar ne kërkesa për rishqyrtim pran AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëmkërkesa/kriteret qëkanëtëbëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa qëlidhen me pretendimet ankimore

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	**Evidencat:**
Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj se është i Autorizuar nga prodhuesi për pjesëmarrje në tender ose nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. (Nuk pranohen autorizimet ne mes distributorëve).	**Evidenca 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje ne tender ose nga zyra përfaqësuese e prodhuesit. Autorizimi duhet te përmbaj te dhënat e tenderit si dhe te dhënat mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, web faqja etj, (për mundësi te verifikimit).**
Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj regjistrimin e produktit nga AKPPM - Autorizimi për Marketing ne Kosove, me dozën e produkteve te kërkuar.	**Evidenca 2. Autorizimi për Marketing nga AKPPM, me dozën e produktit të kërkuar.**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE ankues: "Pharma Leader" L.L.C., - Prishtinë, ka parashtruar ankese kundër ***procedure se negociuar pa publikim te njoftimit për kontrate***, sipas nenit 35.2 te LPP-se, pasi qe nuk është ftuar të tenderoj nga AK – MSH, lidhur me ketë aktivitet te prokurimit.

Komisioni i negocimit/vlerësimit rekomandon se oferta MEDITECH SH.P.K. i ka plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara ne dosje te tenderit dhe është oferte e përgjegjshme.

Komisioni i negocimit/vlerësimit konstaton se çmimi i dhënë nga operatori ekonomik MEDITECH është saktësisht sipas buxhetit te planifikuar sipas hulumtimit te bërë ne kërkesën për tenderim.

Komisioni i negocimit/vlerësimit, kërkon nga përfaqësuesi i OE z. Shkelzen Fetiu që te ofroj zbritje te çmimeve te ofruara ne këtë procedure, duke marre parasysh interesin publik dhe kursimin buxhetor.

Përfaqësuesi i OE z. Shkëlzen Fetiu deklaroj se ne ofertën tone për secilën PEN kemi ofruar nga një gjilpërë, siç ofertën e tone specifikohet se: Terapia me insulina është e pa mundur te behet pa gjilpëra, për këtë arsye ne ofertën tone është e përfshirë një gjilpërë Novo Fine për Pene, gjë që e kemi ofruar edhe gjatë furnizimeve te me hershme.

Sa i përket çmimit përfaqësuesi i OE z. Shkelzen Fetiu deklaroj se çmimi i fundit qe mundem te ofroj pas konsultimit me kompaninë, për Lot 1 është 4.25 € për njësi, për Lot 2 është 4.60 € për njësi.

Bazuar ne zbritjen e ofruar gjate negocimit, oferta ne total për Lot 1 ne total është 212,500.00 € ose zbritje për Lot 1 ne vlere 2,500.00 €.Bazuar ne zbritjen e ofruar gjate negocimit, oferta ne total për Lot 2 ne total është 1,150,000.00 € ose zbritje për Lot 1 ne vlere 12,500.00 €.Komisioni i negocimit/vlerësimit, kërkon nga përfaqësuesi i OE z. Shkelzen Fetiu qe te shikoj mundësinë për te ofruar zbritje shtesë te çmimeve te ofruara.

Përfaqësuesi i OE z. Shkelzen Fetiu deklaroj se zbritja e çmimeve te ofruara është përfundimtare dhe nuk mund te ofroj zbritje.Përfaqësuesi i OE z. Shkelzen Fetiu ofroj sqarimet sa i përket afatit te liferimi, ku ne ofertën e dhënë është pajtuar me afatin e përcaktuar nga AK ne Dosje te tenderit prej 15 ditësh, mirëpo ne rast nevoje për Lot 1 mund ta ofrojmë tërë sasinë për 2 ditë, ndërsa për Lot 2 mund te furnizojmë sasinë prej 150,000 pena për 2 ditë, e sasinë tjetër sipas afatit te rregullt dhe nevojave te AK-MSh.Komisioni i negocimit/vlerësimit, duke marre parasysh rëndësinë e lendes dhe nevojën për furnizim sa me të shpejta me Insulina Analoge për mbi 15,000 paciente insulinvartes, pajtohet me ofertën e dhënë si përfundimtare me zbritje për Lot 1 nga oferta fillestare prej 4.30 € ne ofertën me zbritje 4.25 € për njësi dhe ne total 212,500.00 € , ndërsa për Lot 2 nga oferta fillestare prej 4.65 € ne ofertën me zbritje 4.60 € është 4.60 € për njësi dhe ne total 1,150,000.00 €.Si komision i negocimit/vlerësimit rekomandojmë për dhënie te kontratës ofertën MEDITECH ne vlerën e ofertës me zbritje: Për LOT 1 = 212,500.00 € dhe për LOT 2 = 1,150,000.00 €.

Komisioni i negocimit/vlerësimit e konfirmon se Insulinat e ofertuar nga operatori ekonomik janë me Autorizim Marketing dhe i plotësojnë specifikat e kërkuara teknike

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet të cilat gjenden në platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitur nga operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit si dhe sqarimet e kërkuar nga ZPP – AK, lidhur me opinionin nga KRPP dhe Opininon nga Zyra Ligjore e AK – MSH, lidhur me kete aktivitet te prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Pharma Leader" L.L.C. –Prishtinë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7 dhe 35 te LPP-se, si dhe nenin 52.6 te RRUOPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit, autoriteti kontraktues ka ke vepruar ne pajtim me **nenin 32 par. 2 te LPP-se**, po citoj: *"KRPP-ja do të vendosë rregulla dhe kushte, në përputhje me ligjin e tanishëm dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, që rregullojnë zbatimin e secilës nga procedurat e vendosura të prokurimit nga nenet 32-38 të këtij ligji"*, si dhe kavepruar sipas **nenin 35 par. 2.1 (ii), (iii) te LPP-se**, po citoj:

(ii) nëse, për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i ipet vetëm një operatori të caktuar ekonomik;

(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

Duke njoftuar KRPP-ne përmes formularit B50 Njoftim përpërdorimin e procedurës se negociuar pa publikim te njoftimit për kontratë - neni 35 te datës 22.04.2022 duke ofruar shpjegimin e hollësishëm te fakteve te konsiderueshme dhe justifikimin për përdorimin e procedurës si ne vijim:

Ministria e Shëndetësisë ka te pezulluar (pa vendim ne mungesë te Panelit Shqyrtues te OSHP-se) pas ankesave ne OSHP dy aktivitetet e tenderuar me procedure te hapur për te njëjtat artikuj:

- "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me nr. prokurimi 206-20-8397-1-1-1 dhe nr. te brendshëm 206-20-67-111,
- "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" me nr. prokurimi 206-22-2211-1-1-1 dhe nr. te brendshëm 206-22-11-111,

Ankesa e fundit ne OSHP përkëto insulina është bërë me datën 15.04.2022 dhe nga Njësia e Kërkesës kemi pranuar kërkesën për sigurimin e insulinave për mbulimin e nevojave te pacienteve insulinvartes me qëllim që mos te ketëndërprerje te furnizimit.

Si Div. i Prokurimit kemi kërkuar me e shkrim ape AKPPM te na sigurojnë informacione:

Për Insulinat e përshkruara si me poshtë a keni te regjistruar me Autorizim për Marketing ne Kosovës dhe nëse po cilët prodhues i kane te regjistruar këto produkte?

Përshkrimi i Insulinave për te cilat po kërkojmëpërgjigjeështë si ne vijim:

1) **Insuline analoge me veprim te shpejte, shiring e parambushur, 100 IU/ml, 3ml**
2) **Insuline analoge bifazike (premix) me veprim të shpejtë dhe te mesëm, shirnge e parambushur, 100 IUml, 3ml**

Nga AKPPM kemi pranuar listën e insulinave te regjistruara sipas prodhueseve dhe mbi këtë baze do te dërgohen ftesat për ofertim ne këtë aktivitet përkompanitë qe i kane produktet e regjistruara me Autorizim për Marketing ne Kosove, konform edhe opinionit ligjor nga Dep. Ligjor i MSH-se e lidhje me Autorizimin për Marketing sipas legjislacionit ne fuqi,

Bazuar ne stokun aktual te insulinave, jemi te detyruar qe ta zhvillojmëkëtë aktivitet, pasi që në të kundërtën dështimi i kontraktimit dhe furnizimit me Insulina Analoge, rrezikon shëndetin publik te mbi 15,000 pacienteve insulinvartes.

Në bazë të arsyeve të lartcekura, konsiderojmë se është i arsyeshëm përdorimi i procedurës se negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me disa operator ekonomik, për kontraktimin e këtyre produkteve, kontratë kornizë, me çmime te tregut qe janë nxjerre nga komisioni për hulumtimin e çmimeve te tregut andaj nuk ka rrezik për sa i përket aspektit ekonomik te çmimeve.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK – ZPP përmes platformës se e-prokurimit me date: 04.05.2022 ka dërguar Letrat standard e ftesës për negociata për operatoret ekonomik: *1. "Meditech" Sh.p.k.* dhe *2. "Asgeto" Sh.p.k.*, kurse sipas proces-verbalit të hapjes të datës 06.05.2022 ka tenderuar vetëm OE: "*Meditech" Sh.p.k.*
Gjithashtu, AK-MSH-ZPP ka pranuar një opnion nga KRPP me datën 27.04.2022 lidhur me këtë procedure te prokurimit. Autorizimin për shqyrtim në këtë lëndë kam pranuar me date 24.05.2022, ndërsa AK me date 25.05.2022 ngrit ne platformën elektronike nënshkrimin e kontratës me OE *Meditech.*
***Provë**: Opinioni i KRPP-së*

Prandaj, **eksperti shqyrtues sqaron** se autoriteti kontraktues – zyrtari përgjegjës i prokurimit – zyrtari i prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes se tenderit. Rrjedhimisht përgjegjësia mbi përzgjedhjen e kritereve te përzgjedhjes dhe kritereve te dhënies, bie apo është përgjegjësi e plote mbi autoritetin kontraktues. ZPP - Zyrtari i Prokurimit është përgjegjëspër përgatitjen e dosjes se Tenderit. Ai është plotësisht përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve te Tenderit, kritereve te përzgjedhjes, si dhe kritereve te dhënies, ndërsa specifikimet teknike do te përgatiten nga struktura te specializuara ne çështjen qe do te prokurohet, brenda autoritetit kontraktues.

Gjithashtu, **Eksperti shqyrtues sqaron si ne vijim:** Është në përgjegjësi dhe në **diskrecion të autoritetit kontraktues** të përcaktohet në shfrytëzimin dhe zbatimin e secilës nga procedurat e vendosura te prokurimit nga nenet 32-38 të këtij ligji të LPP-së, në përgatitjen e dosjes së tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në aneksin 1 të FDT-së, vlerësim i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në FDT. Ndërsa lidhur me përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës bartë përgjegjësin komisioni i vlerësimit të ofertave i autoritetit kontraktues, sepse **nga eksperti shqyrtues nuk janë shqyrtua pretendimet e OE ankues (*pasi që janë disa ekspertiza lidhur me prokurimin:*** *"Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale",* ***nga ekspertet e OSHP-së, mirëpo mbeten të marrin epilog nga Paneli Shqyrtues*)**, duke sqaruar se barra e provës tek procedurat e negociuar bie mbi Autoritetin kontraktues, sepse çdo interpretim apo analizim i këtyre pretendimeve të parashtruara nga OE ankues tek, Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës Neni 35 i LPP-së, mund te interpretohet si ndërhyrje në kompetenca të autoritetit kontraktues (*siç është rasti me OE ankues, ku AK nuk i dërgon ftesën për tenderim nga AK, pasi që konsiderojë se është në* ***kompetence/përgjegjësi/barrë e AK në procedurat e negociuar të LPP-së***).

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE, **të aprovohet si pjesërisht të bazuar**, dhe duke marr për bazë te gjitha sqarimet dhe ngjarjet e ndodha me këtë aktivitet prokurimit- procedure të prokurimit, është e pamundur te jap një rekomandim tjetër korrigjues, pasi që tashme kontrata është nënshkruar dhe kjo mbetet nën përgjegjësin e AK-MSH.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "Pharma Leader" L.L.C. – Prishtinë*